

Kthim pergjigje nr. 166

Fri 4/3/2020 11:33 AM

To: [Im@tv.t.al](mailto:Im@tv.t.al);

Përshëndetje!

Në përgjigje të kërkesës tuaj dërguar me shkresen Nr. 5 Prot. date 28.02.2020 ne Drejtorinë Rajonale te Tatimeve Tirane në kuadër të Ligjit 119/2014 datë 18.09.2014 “Për të drejtën e informimit”, regjistruar me nr. 166 në regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, ju sqarojmë si më poshtë vijon:

Lidhur me sa kërkohet për zbatimin e rekomandimeve të lëna sqarojmë se Drejtori Rajonale ka nxjerrë Urdhërin nr.2 datë 16.01.2019 sipas të cilit urdhëron dhe përcakton se të gjithë inspektorët duhet të analizojnë raportin e KLSH-së dhe të zbatojnë rekomandimet dhe detyrat e lëna , kjo në funksion të detyrave funksionale të parashikuara dhe në manualet përkatëse (manuali i kontrollit tatimor; manual i kontrollit nga zyra; manuali i mbledhjes me forcë; manuali i shërbimit ).

Në zbatim të Regullores dhe të Manualit të Kontrollit nga zyra, në përmbushje të detyrave funksionale si dhe në ndjekje të detyrave të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit secili inspektor për çdo tatimpagues të intervalit që administron, kryen monitorimin në mënyrë të vazhdueshme si vijon :

***PËR TVSH-në :***

- Inspektorët analizojnë dhe raportojnë mbi gjëndjen e inventarit në tatimpaguesit të cilët do të rezultojnë me risk, duke iu referuar deklarimeve dhe librave të muajit të mëparshëm dhe rënies së pagesës së TVSH-së. Evidentim dhe dërgim shkresash tatimpaguesit, ose propozime për vizita fiskale sipas rastit. *(Të raportohet deri më datë 10 të cdo muaji)*
- Inspektorët analizojnë dhe raportojnë mbi tatimpaguesit me gjendje të lartë kreditore të TVSH-së , duke iu referuar deklarimeve dhe librave të muajit të mëparshëm. *(Të raportohet deri më datë 5 të cdo muaji)*
- Inspektorët analizojnë dhe raportojnë mbi tatimpaguesit të cilët rezultojnë me rentabilitet të ulët, (ulët konsiderueshëm me mesataren e sektorit të aktivitetit që kryejnë), duke iu referuar deklarimeve dhe librave të muajit të mëparshëm dhe atij koherent. *(Të raportohet deri më datë 5 të cdo muaji)*
- Cdo inspektor identifikon, përpunon dhe raporton listën e tatimpaguesve me blerjet më të mëdha dhe shitje relativisht më të ulta ose të barabarta me blerjet. Analizon ne menyre te hollësishme librat të tyre si dhe kërkon informacion nëse këto blerje i shërbejnë aktivitetit apo jo.

Evidenton subjektet të cilët pretendojnë që nuk kanë fuqi paguese, verifikon librat e tyre si dhe transaksionet me të tretët , mënyra e likuidimit. *(Të raportohet deri më datë 10 të cdo muaji)*

- Çdo inspektor kryen monitorimin në mënyrë të vazhdueshme, për të gjithë tatimpaguesit në administrim, të qarkullimit të realizuar me pajisje fiskale me qëllim rritjen e bazës së tatimpaguesve të rregjistruar me tvsh si dhe ata të cilët kanë kaluar pragun e xhiros për të kaluar me T.F. *(Të raportohet deri në fund të cdo muaji)*
- Çdo inspektor identifikon subjektet të cilët deklarojnë për një kohë të gjatë gjendje kreditore të T.V.SH-së dhe ben analizimi i tyre, shkakun përse është në këtë gjendje, analizimi i këtyre subjekteve me subjektet e tjerë analogë të cilët që operojnë në të njëjtin sektor. *(Të raportohet deri në fund të cdo muaji)*
- Çdo inspektor komunikon për pagesën e mundshme të detyrimit me tatimpaguesit të cilët në deklaratën koherente të tvsh-se rezultojnë me pagesë dhe nuk e kanë kryer këtë pagesë brenda datës 14. *(Të raportohet nga data 14 deri më datë 24 të cdo muaji)*
- Lidhur me monitorimin dhe raportimin për TVSH-në, përgatitet në fund të cdo muaji analizë mbi verifikimet dhe masat e marra për problematikat e poshtë shënuara:
  - Tatimpaguesit të cilët gjatë tre muajve të fundit kanë rritur blerjet në krahasim me shitjet, kontaktimi për cdo tatimpagues për transaksionet e kryera.
  - Evidentimi i tatimpaguesve me xhiro të konsiderueshme që nuk deklarojnë on-line librat, t'u kërkohet të depozitojnë urgjentisht ato elektronikisht.
  - Për subjektet që operojnë në fushën e ndërtimit të apartamenteve, a janë ndjekur planet e pagesave për TVSH, Tatim Fitimi dhe Sigurime Shoqërore. Të dërgohet shkresë për të gjithë tatimpaguesit që operojnë në këtë fushë. Të merren situacionet e objekteve, në çfarë faze janë punimet si dhe të analizohet gjendja e tyre.
  - Evidentimi i tatimpaguesve që nuk kanë deklaruar në muajin paraardhës. Verifikimet e duhura lidhur me deklarimin e librave apo përdorimin e pajisjeve fiskale, të dhenave nga dogana etj.
  - Evidentimi i tatimpaguesve që deklarojnë me zero. Të kryhen verifikimet e duhura lidhur me aplikim për mbyllje apo pezullim, deklarim librash apo përdorimin e pajisjeve fiskale. Të kontaktohen të gjithë tatimpaguesit.
  - Evidentimi i tatimpaguesve që kanë ndërprerë deklaratat e T.V.SH-së dhe ata që nuk kanë deklaruar shitje por vetëm blerje, në 2 periudhat e fundit tatimore. Të kryhen verifikimet lidhur me përdorimin e pajisjes fiskale, dhe për subjektet me risk më të lartë (nuk janë në fazë investimi, blerjet janë të larta dhe kanë të bejnë me mallra qarkulluese) të kalohet lista tek DHT për verifikim në vend të aktivitetit).
  - Verifikimi dhe monitorimi i xhiros në pajisje fiskale i subjekteve sidomos me aktivitete "Profesionet e lira", "Sherbim" e "Tregti".
  - Mbikqyrja e të dhenave doganore mbi realizimin e importeve dhe rakordimi i tyre me deklarimin e tatimpaguesit në FDP-në e TVSH-së. Për parregullsitë e konstatuara të kërkohet informacion zyrtar nga tatimpaguesi e dogana. Në përfundim të procesit të bëhet rivlerësimi i situatave të tatimpaguesit konform legjislacionit tatimor në fuqi.

## ***PËR TATIMIN MBI FITIMIN***

- Çdo inspektor kujdeset për arkëtimin në masën 100% kësteve paraprake të tatimit mbi fitimin.
- Çdo inspektor do të ndjekë arkëtimet e kësteve të papaguar të periudhave të kaluara.
- Çdo inspektor do të ndjeke arketimet e deklaratës së T.F për ato tatimpagues të cilët kanë deklaruar dhe nuk kanë paguar.

*(Të raportohet nga data 20 deri në fund të cdo muaji)*

### ***PËR TATIMIN NË BURIM***

- Çdo inspektor përditëson regjistrin e qerasë për subjektet që ka në administrim .
- Çdo inspektor verifikon përputhshmërinë mes deklarimeve në deklaratën e tatimit në burim me kontratat e qerasë .
- Çdo inspektor kujdeset për arkëtimin e detyrimeve të Tatimit në Burim brenda muajit për ata që kanë bërë deklaratën dhe nuk e kanë paguar.

*(Të raportohet nga data 20 deri në fund të cdo muaji)*

### ***PËR SIGURIMET SHOQËRORE DHE SHËNDETESORE***

- Çdo inspektor verifikon formularët ESIG 027 dhe analizon largimin e punonjësve për tatimpaguesit të cilët kanë larguar një numër të konsiderueshëm punonjësish.
- Çdo inspektor kujdeset për arkëtimin e detyrimeve të Sigurimeve brenda muajit për ata që kanë bërë deklaratën dhe nuk e kanë paguar.

*(Të raportohet nga data 20 deri në fund të cdo muaji)*

Për cdo informacion të nevojshëm për mbarëvajtjen e punës cdo inspektor dhe përgjegjësats shfrytëzojnë raportet mujore të nxjera nga IT në Rubriken ANTIVIRUS dhe kërkojnë raporte pranë Agencisë Kombetare të Shoqërisë së Informacionit, Drejtorisë së TIK Tatime, sipas nevojave të tyre të përditshme në lidhje me verifikimet, ndjekin problematikat dhe raportimet ditore apo mujore që kryhen nga sektori i Kontrollit nga Zyra.

- Lidhur me rekomandimin në të cilin është përcaktuar se Drejtoria e Kontrollit Tatimor të programojë dhe të zbatojë planet e punës të miratuar nga DPT për përfundimin e afateve të kontrollit , sqarojmë se lidhur me zbatimin e planit të punës së miratuar nga DPT, çështja e orëve për inspektor kontrolli, programimi sipas llojit të tatimeve , programimi i datës së nisjes së kontrollit , Drejtoria e Kontrollit Tatimor zbaton rregulloren nr. 2 “ Mbi procedurat e përzgjedhjes për kontroll të tatimpaguesit” “ Manual i Menaxhimit të riskut” bazuar dhe në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “ Për procedurat tatimore në R.SH-së” , i ndryshuar neni 80” Kontrolli tatimor “, pika 4 “ Zgjedhja e tatimpaguesve që kontrollohen bëhet në bazë të analizës së vlerësimit të riskut , të kryer nga administrata tatimore , për të identifikuar tatimpaguesin që ka më shumë rrezik për ta shkelur legjislacionin tatimor”.
- Nga ana e përgjegjësve të kontrollit çdo muaj bëhet përzgjedhja e tatimpaguesve që do të kontrollohen si pjesë e 30% të orëve të punës për muajin në vazhdim , deri në datë 15 te muajit bëhet përzgjedhja e tatimpaguesve që do të kontrollohen në muajin pasardhës.

- Përsa rekomandohet në rastin e kontrollit të tatimpaguesve me qarkullim të konsiderueshëm dhe vlera të larta të kërkesave për rimbursim , sqarojmë se kontrolli i kërkesave për rimbursim të TVSH-së , trajtohet në Manualin e rimbursimit të TVSH-se , lidhur me kryerjen e procedurave të rimbursimit të TVSH-së për trajtimin dhe verifikimin të vlefshmërisë së kërkesave për rimbursim si dhe kryerjen e rimbursimit të TVSH-së nëpërmjet Degës së Thesarit.
- Rimbursimi i TVSH-së realizohet nëpërmjet një procedure të mirëpërcaktuar, të fokusuar në analizën e riskut për rimbursim, sipas të cilës jo çdo kërkesë për rimbursim i nënshtrohet procedurave të kontrollit tatimor. Rimbursimi i TVSH-se mbështetet në kritere objektive që e lidhin procesin e rimbursimit me modelin e riskut. Gjithashtu në rregulloren nr.6374 prot. datë 23.03.2018” Për Rimbursimin e TVSH-së mbështetur në analizën e riskut” nuk është përcaktuar si kusht që grupi i kontrollit të ketë të paktën 2 inspektorë.

Lidhur me sa kërkohet për tatimpaguesit që rezultojnë me Humbje , DRTatimore ka kryer analizat dhe verifikimet përkatëse , duke kryer dhe vlerësime tatimore me efekt në uljen e humbjeve .

Përsa kërkohet nëse janë filluar procedurat e falimentit sipas Ligjit nr. 110/2016 datë 27.10.2016 “ Për falimentimin” , lidhur me mundësinë e zbatimit të këtij ligji, sqarojmë se në takimin e organizuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve nga ana jonë janë parashtruar detaje mbi mundësitë e zbatimit të këtij ligji.

Për minimizimin apo mbledhjen e detyrimit të papaguar apo për të cilin tatimpaguesit ndodhen debitore ndaj DRT Tiranë, pas ezaurimit të masave shtrënguese, një prej mundësive që na krijon tej hapesirave që ka parashikuar ligji organik Nr.9920 datë 19.05.2008 ‘Për procedurat Tatimore në RSH’, i ndryshuar, është mbështetja te Ligji Nr.110/2016 ‘Për Falimentin’, duke qenë në rolin e Kreditorit.

Në lidhje me zbatimin e ligjit Nr.110/2016 ‘Për Falimentin’, si subjekt iniciues i kësaj procedure në bazë të nenit 13, 16 dhe 18 të ligjit të sipërcituar, mund të krijoje një mundësi të re, për mbledhjen e atyre debive, për të cilat Drejtoria e Kontrollit nga Zyra dhe Drejtoria e Mbledhjes me Forcë në DRT Tiranë kanë rezultuar të pasuksesshme kjo, për arsye objektive dhe subjektive.

Por, marrja e nje roli të tillë dhe fillimi i procesit gjyqësor në Seksionin Tregtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë ( Dhoma Civile) jo vetëm që përbën një përgjegjësi por kërkon maturi në pjekjen e kushteve objektive lidhur me sjelljen ndaj tatimpaguesve në perputhje të plotë me ligjin tonë organik.

- Burimet njerëzore , duke mos patur një njohuri të veçantë mbi kushtet , pengesat, risqet dhe parashikimet e Ligjit Nr.110/2016 ‘Për Falimentin’, do të kishin nevojë për një trajnim .
- Në parashikimet që Ligji i ri ka prezantuar roli i iniciuesit të procesit paraqitet tepër kompleks dhe në këtë kuptim do të duhet një punë e madhe përgatitore, për të konkluduar

nëse masat administrative të institucionit janë ezauruar të gjitha apo jo, dhe hulumtimi me pas në rezultatet e korespondencës me institucionet e tjera publike dhe private, apo edhe investigim psh.nga përmblyesit gjyqësor për gjetjen e pjesëve të masës së falimentit dhe arrijten e rezultati që të përmbysë pretendimet e debitorit , Kreditorit te përkohshëm dhe ekspertit ( neni 19 / c) se masa nuk mjafton në çeljen e kësaj procedure. Pra, mund të ketë shpenzime pa u çelur procesi i falimentit, ndërkohë që nuk është parashikuar një fond për përballimin e shpenzimeve.

- Gjithashtu sado të mundet që në mbështetje të nenit 34, 36, 37 dhe 38 i ligjit Nr.110/2016 ‘Për Falimentin’ dhe neni 605 i K.Civil të RSH) të lokalizojmë prapakisht se cilët mund të jenë Kreditorët e siguruar, Personat që kanë të drejta të veçanta mbi pasuritë e debitorit, dhe raporti mes kalkulimit tonë se ku hyjmë bëjmë pjesë në rradhën e preferimit dhe masës së gjendur nga ana jone të falimentit apo të pasurisë.Kjo kërkon kohe, burime njerëzore të kualifikuar dhe shpenzime.
- Duke patur parasysh përbërjen e Komitetit të Kreditorëve ( që ligji i ri parashikon neni 29/dh dhe 50/2) , një organ kolegjal shumë i rëndësishëm në këtë proces ( me të pakten 3 anëtare dhe jo me shume se 5 anëtare), evidentimi se në çfarë pozicioni radhiten kreditë tona në krahasim me ato të kreditorëve të tjerë mbetet fundamental në kuptimin që duhet të sigurojmë me patjetër një vend dhe të mundohemi që një analize të tille ta perthithnim që në fillim të procesit.Po me ç’ menyra ??, mbetet për tu diskutuar.

Çështjet objekt falimenti janë të konsiderueshme, dhe kjo kërkon edhe burime njerëzore të mjaftueshme në Sektorin Juridik, mbështetje në buxhet, ku në kërkesat buxhetore të vitit 2018 dhe 2019 nuk janë parashikuar.

Në kushtet dhe rrethanat e sipërcituara, DRTatimore Tiranë , nuk ka në proces procedura lidhur me falimentin.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin , ju urojmë punë të mbarë.